



WATER AND WASTE REGULATORY OFFICE
ZYRA RREGULLATORE PËR UJË DHE MBETURINA
REGULATORNI URED ZA VODU I OTPAD

RAPORT

NGA HULUMTIMI PËR QËNDRIMET E KONSUMATORËVE
RRETH SHËRBIMEVE PUBLIKE PËR UJË DHE MBETURINA NË
KOSOVË

Prishtinë

dhjetor 2008

Pjesëmarrësit në projekt:

Afrim Lajçi, Udhëheqës i Projektit
Sylë Sylja, Koordinator i Projektit

Bashkëpunëtorë të Jashtëm:

Hulumtues në terren:

Rexhep Musliu, udhëheqës
Ibadete Ahmeti, udhëheqës
Blerta Ahmeti
Byrhan Bivolaku
Mevlude Musliu

Analiza e të dhënave dhe draftimi i raportit:

Petrit Tahiri

Përgatitur dhe Publikuar nga:

Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina

Prishtinë, 2008

Përmbajtja

1. Hyrje	4
2. Qëllimi	4
3. Metodologjia	5
4. Të dhënat demografike të respondentëve.....	5
5. Opinioni i qytetarëve lidhur me shërbimet publike në Kosovë.....	7
5.1. Sa kanë qasje qytetarët në shërbimet publike përkatëse?	7
5.2. Sa janë konsumatorët të kënaqur me shërbimet publike?	8
5.3. Si i konsiderojnë konsumatorët tarifat e shërbimeve publike?.....	10
5.4. Në ç`masë i paguajnë konsumatorët faturat për shërbimet publike?.....	11
6. Njohuritë e konsumatorëve për ZRRUM dhe për KKK	13
6.1. Njohuritë e konsumatorëve për Zyrën rregullatore për Ujë dhe Mbeturina	13
6.2. Njohuritë e konsumatorëve për Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve.	13
7. Konkluzione dhe Rekomandime.....	14
Shtojca 1:.....	17
Të Dhënat Statistikore të Hulumtimit	17
Shtojca 2:.....	37
Formati i Pyetësorit.....	37

1. Hyrje

Kosova, edhe gati dhjetë vjet pas luftës, vazhdon të ketë vështirësi dhe sfida të mëdha në të gjitha sferat e jetës. Pa dyshim se këto sfida dhe vështirësi prekin të gjithë sektorët, veçanërisht ata sektorë të cilët ofrojnë shërbime për qytetarët. Sfidat e kompanive që merren me këta sektorë janë nga më të ndryshmet, që nga mungesa e burimeve bazë për zhvillimin e veprimtarisë, sigurimi i kualitetit të shërbimeve që u ofrohen qytetarëve, inkasimi i mjeteve, përmbushja e obligimeve të qytetarëve ndaj këtyre kompanive, e shumë vështirësi të tjera të cilat janë pengesë e zhvillimit të sektorëve të shërbimeve publike.

Me qëllim të sigurimit të shërbimeve kualitative, me çmime të arsyeshme, dhe me standarde të larta, në Kosovë janë themeluar disa autoritete të pavarura rregullatore. Një nga këto autoritete është Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturinave (ZRRUM) që ka përgjegjësi rregullimin e aktiviteteve të kompanive publike që ofrojnë shërbimet e ujësjellësit, kanalizimit dhe mbeturinave në Kosovë. Roli primar i ZRRUM është që të mbrojë interesat e konsumatorëve në kushtet e shërbimeve me karakter monopoli çfarë janë shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit dhe (aktualisht) shërbimet e mbeturinave.

ZRRUM, për tu njohur më mirë me opinionet dhe perceptimet e konsumatorëve rreth shërbimeve publike për ujë dhe mbeturina ka iniciuar një hulumtim të opinionit të konsumatorëve.

2. Qëllimi

Qëllimi i këtij hulumtimi është që ZRRUM dhe palët tjera të interesit të njoftohen me qëndrimet e konsumatorëve para së gjithash rreth shërbimeve publike të ujësjellësit dhe mbeturinave por edhe të shërbimeve tjera publike për të fituar një pasqyrë se si është raporti i këtyre shërbimeve me shërbimet tjera publike në aspektin e kënaqshmërisë së konsumatorëve. Poashtu, qëllim i hulumtimit është të fitohet një pasqyrë sa i përket shkallës së njohurisë që kanë konsumatorët për ekzistencën si dhe rolin dhe përgjegjësitë e ZRRUM si dhe për Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve (KKK) të cilat i ka themeluar ZRRUM në 7 regjionet e Kosovës për ti adresuar brengat dhe ankesat e konsumatorëve lidhur me shërbimet e ujësjellësit dhe mbeturinave në Kosovë.

Gjetjet nga ky hulumtim do të përdoren si udhërrëfyes për ndërmarrjen e veprimeve të cilat i adresojnë shqetësimet e konsumatorëve dhe përmirësojnë nivelin e shërbimeve dhe imazhin e ZRRUM si dhe kompanive publike që ofrojnë këto shërbime.

3. Metodologjia

Hulumtimi është kuantitativ, dhe është zhvilluar në tërë territorin e Kosovës. Janë intervistuar gjithësej 1200 respondentë. Në terren është shfrytëzuar mostra jo e rastit, mostra “top bore”. Ky lloj i mostrës është shfrytëzuar për identifikimin e vendeve ku do të zhvillohet hulumtimi. Hulumtimi është realizuar nga një grup hulumtuesish të cilët kanë qenë të monitoruar gjatë gjithë kohës. Në përbërje të ekipit që ka punuar në terren ka qenë një përfaqësues më kompetent në lidhje me këtë hulumtim (kjo ka ndihmuar që të kemi rezultate më të sakta nga terreni).

Hulumtimi është realizuar në periudhën kohore nëntor – dhjetor 2008.

Fazat e hulumtimit	Nëntor	Dhjetor
Faza I – Puna në terren		
Faza II – Analiza e të dhënave		

4. Të dhënat demografike të respondentëve

Është tentuar maksimalisht që pjesë e këtij hulumtimi të jenë kryefamiljarët e ekonomive familjare, përkatësisht ata, në emër të të cilëve ofrohen shërbimet publike.

Në **Tabelën 1** është paraqitur përkatësia gjinore e respondentëve. Siç shihet nga tabela nga 1200 respondentë sa kanë marrë pjesë në hulumtim 60.2% e tyre, apo 722 kanë qenë të gjinisë mashkullore, ndërsa 478 sish apo 39.8 % të gjinisë femërore.


Tabela 1: Përkatësia gjinore e respondentëve

Gjinia	Numri i respondentëve	Përqindja
Mashkull	722	60.2%
Femër	478	39.8%

Në Tabelën 2 është dhënë pasqyra e respondentëve sa i përket llojit të vendbanimit.

Tabela 2: Lloji i vendbanimit

Vendbanimi	Numri i respondentëve	Përqindja
Fshat	398	33.2%
Qytezë	78	6.5%
Qytet	724	60.3%



Grafiku 1:
Vendbanimi dhe gjendja ekonomike e respondentëve

Në **Grafikun 1** gjendja ekonomike e respondentëve sipas llojit të vendbanimit. Siç mund të shihet, 13.2% të respondentëve kanë deklaruar se të ardhurat e tyre nuk mjaftojnë as për ushqim. Ky tregues është mjaft shqetësues dhe alarmues. Ky grafik gjithashtu na tregon se vendet rurale, përkatësisht fshatrat qëndrojnë më keq për sa i përket gjendjes ekonomike. Në anën tjetër, është sinjifikativ fakti se vetëm 4 nga 1200 respondent kanë thënë se të ardhurat e familjes mundësojnë jetesë shumë të mirë dhe mundësi për kursime.

Në fillim të këtij raporti u tha se Kosova po vazhdon të përballet me probleme dhe sfida të ndryshme. Në këtë aspekt një problem i tillë është niveli i arsimit të popullatës që është paraqitur në **Tabelën 3**. Këtu shihet niveli mjaft i ulët i edukimit të popullatës, dhe në veçanti i gjinisë femërore.

Tabela 3: Shkalla e arsimimit e respondentëve sipas gjinisë

Shkalla e arsimimit							
Gjinia	Pa shkollë	Shkollë fillore e papërfunduar	Shkollë fillore e të përfunduar	Shkollë e mesme	Shkollë e lartë ose fak. i papërfunduar	Fakultet	Master/Dr. Sc./Specialist
Mashkull	15	45	104	368	106	74	9
Femër	25	61	188	145	30	29	0

5. Opinioni i qytetarëve lidhur me shërbimet publike në Kosovë


Në këtë sondazh objekt hulumtimi kanë qenë shërbimet publike të cilat ofrohen nga kompanitë publike siç janë: (i) furnizimi me ujë dhe kanalizimi, (ii) grumbullimi i mbeturinave, (iii) furnizimi me energji elektrike, (iv) telefonia fikse, dhe (v) ngrohja qendrore. Funksonimi i autoriteteve rregullatore konsiderohet të ndikojë që këto shërbime të jenë të një niveli më të lartë dhe të minimizohen efektet negative të monopolit që kanë kompanitë publike që ofrojnë këto shërbime. Megjithatë, zhvillimi dhe ngritja e cilësisë së këtyre shërbimeve mbetet edhe mëtutje një sfidë që kërkon angazhim dhe përkushtim të kompanive shërbyese si dhe një regjim efektiv rregullator i përcjellur me mbështetje institucionale nga të gjitha palët e interesit në Kosovë. Në veçanti, zgjerimi i shërbimeve në zonat rurale me qëllim të ngritjes së kualitetit të jetesës dhe mirëqenies së popullatës mbetet një fushë që kërkon një angazhim të koordinuar të insitucioneve relevante.

5.1. Sa kanë qasje qytetarët në shërbimet publike përkatëse?

Sa i përket shtrirjes së shërbimeve, ekziston një dallim i madh në mes të zonave rurale dhe atyre urbane. Në këtë plan, problemi është më i theksuar tek **shërbimet e ngrohjes qendrore (97.6%** e respondentëve nuk ka qasje në këtë shërbim) dhe **shërbimet e telefonisë fikse (63.2 %** e respondentëve nuk kanë qasje në këtë shërbim). Ndërkaq sa i takon shërbimeve të cilat i rregullon Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina, problemi më i madh paraqitet tek shkalla relativisht e lartë e pambulueshmërisë me **shërbime të grumbullimit të mbeturinave (22.3 %** e respondentëve nuk ka qasje) dhe tek **shërbimet e kanalizimit të ujërave të zeza (13.4 %** e respondentëve nuk ka qasje).

Në anën tjetër konsumatorët e intervistuar kanë mbulueshmëri të plotë me **shërbimet e energjisë elektrike (100%)** dhe poashtu një shkallë shumë të lartë të mbulueshmërisë me **shërbimet e ujësjellësit (99.7 %)**. Kjo në masë të madhe ka ndodhë për faktin se me rastin e përzgjedhjes së vendbanimeve për kryerjen e hulumtimit është tentuar të përfshihen ato vendbanime ku ofrohen shërbimet e ujësjellësit.

Në **grafikun 2** është paraqitur qasja e qytetarëve në shërbimet publike.



Grafiku 2: Shkalla e ofrimit të shërbimeve publike te qytetaret


Edhe pse në grafikun e mësipërm shihet se shkalla e ofrimit të disa shërbimeve është në nivel të kënaqshëm, ky tregues nuk pasqyron kualitetin e këtyre shërbimeve.

5.2. Sa janë konsumatorët të kënaqur me shërbimet publike?

Prej 1200 respondentëve të përfshirë në hulumtim, një numër i tyre nuk janë përfitues të disa shërbimeve publike, prandaj këta respondent nuk janë përfshirë me analizën e rezultateve lidhur me atë se sa janë të kënaqur me këto shërbime.

Për secilin shërbim publik është dhënë numri i saktë i atyre që janë përfitues të këtyre shërbimeve:

a. Ujësjetllesi dhe kanalizimi – 1191 respondent të përfshirë




Grafiku 3.1:

Kënaqshmëria e konsumatorëve me shërbimin e ujësjetllesit dhe kanalizimit

Nga **Grafiku 3** shihet se një numër mjaft i madh i qytetarëve nuk janë të kënaqur me këto shërbime. Kështu, **52.1%** e respondentëve kanë deklaruar se janë *shumë të kënaqur* ose *të kënaqur* me shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit ndërkaq **25.4%** rezultojnë të jenë *të pakënaqur* ose *shumë të pakënaqur* me këto shërbime.

b. Grumbullimi i mbeturinave – 946 respodent të përfshirë




Grafiku 3.2:

Kënaqshmëria e konsumatorëve me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave

Nga hulumtimi i kryer rezulton se **61.2%** e respondentëve kanë deklaruar se janë *shumë të kënaqur* ose *të kënaqur* me shërbimet e grumbullimit të mbeturinave ndërkaq **14.3%** rezultojnë të jenë *të pakënaqur* ose *shumë të pakënaqur* me këto shërbime.

c. Furnizimi me energji elektrike – 1196 respodent të përfshirë




Grafiku 3.3:

Kënaqshmëria e konsumatorëve me shërbimin e furnizimit me energji elektrike

Përgjigjet e respondentëve lidhur me shërbimet e furnizimit me energji elektrike reflektojnë një shkallë të lartë të pakënaqësisë me këtë shërbim. Konkretisht, nga hulumtimi i kryer del se vetëm **13.96%** e respondentëve kanë deklaruar se janë *shumë të kënaqur* ose *të kënaqur* me shërbimet e furnizimit me enrgji elektrike ndërkaq **64.07%** rezultojnë të jenë *të pakënaqur* ose *shumë të pakënaqur* me këto shërbime. Sigurisht se situata e përgjithshme energjetike, si dhe ndaljet e shpeshta

të energjisë elektrike kanë bërë që pakënaqësia e qytetarëve për këtë shërbim të jetë mjaft e madhe.

d. Shërbimi i telefonisë – 438 respondent të përfshirë



Grafiku 3.4: Sa qytetarët janë të kënaqur me shërbimin e telefonisë

Për dallim prej disa shërbimeve tjera, me shërbimin e telefonisë qytetarët janë mjaft të kënaqur – 90.17% e respondentëve janë *shumë të kënaqur* ose *të kënaqur* me shërbimet e telefonisë ndërkaq vetëm **2.07%** rezultojnë të jenë *të pakënaqur* ose *shumë të pakënaqur* me këto shërbime. Duhet të theksohet se shtrirja e këtij shërbimi në zonat rurale thuhet mungon totalisht.

Dhe në fund sa i përket **ngrohjes qendrore 50%** e respondentëve janë *shumë të kënaqur* ose *të kënaqur*, ndërkaq vetëm **34.17%** rezultojnë të jenë *të pakënaqur* ose *shumë të pakënaqur* me këtë shërbim.

Nga hulumtimi del se konsumatorët janë më së shumti të kënaqur me shërbimet e telefonisë (mbi 90% e konsumatorëve janë 'shumë të kënaqur' ose 'të kënaqur' me këtë shërbim). Në vendin e dytë qëndrojnë shërbimet e grumbullimit të mbeturinave (61.2 % e respondentëve kanë deklaruar të jenë 'shumë të kënaqur' ose 'të kënaqur' me këtë shërbim) dhe pas tyre vijnë shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit (mbi 52% të respondentëve rezultojnë të jenë 'shumë të kënaqur' ose të kënaqur' me këtë shërbim). Shkalla më e lartë e pakënaqësisë me nivelin e shërbimeve është konstatuar për shërbimet e energjisë elektrike ku vetëm 13 % të respondentëve janë 'shumë të kënaqur' ose të 'kënaqur' me nivelin e këtij shërbimi.

5.3. Si i konsiderojnë konsumatorët tarifat e shërbimeve publike?

Tërthorazi u tha edhe më herët, megjithatë, duhet patjetër të ritheksohet se hulumtimi ka konfirmuar se gjendja ekonomike e cila mbretëron në Kosovë është sipas qytetarëve një arsye mjaft e fortë përse i përket kryerjes së obligimeve ndaj ofruesve të shërbimeve

publike. Në **Tabelën 1.4** është paraqitur në mënyrë të detajuar se çka mendojnë qytetarët rreth tarifave të shërbimeve publike.

Në paraqitjet grafike më lart u pa se ka pakënaqësi rreth ofrimit të shërbimeve publike, edhe pse nuk është thënë në mënyrë eksplicite, nga prurjet e këtyre dy pyetjeve mund të konsiderohet se një ndër shkaqet e kësaj pakënaqësie, janë pikërisht tarifat e larta të disa prej këtyre shërbimeve. Veçanërisht duhet cekur se shumica absolute e respondentëve janë deklaruar se tarifat e energjisë elektrike janë shumë të larta, përkatësisht të larta (92.2%). Kështu, 44.3% kanë deklaruar se çmimet e nergjisë elektrike janë shumë të larta, ndërsa 47.9% janë shprehur se çmimet janë të larta. Ndërsa vetëm 0.2% janë shprehur se këto çmime janë te ulëta, gjegjësisht të arsyeshme.

Tabela 4: Si i konsiderojnë konsumatorët tarifat e shërbimeve publike

	Ujësjiellësi dhe kanalizimi (1191 respon.)	Grumbullimi i mbeturinave (930 respon.)	Ennergjia elektrike (1200 respon.)	Telefonia (439 respon.)
Shumë të larta	4.53%	1.72%	44.33%	5.69%
Të larta	48.44%	28.49%	47.91%	32.57%
Të përballuesh.	44.84%	66.77%	6.91%	58.54%
Të ulëta	1.59%	2.04%	0.16%	3.18%
Nuk e di	0.59%	0.97%	0.66%	/

Nga Tabela 4 mund të shihet se më tepër se gjysma e konsumatorëve të intervistuar mendojnë se për shërbimet e ujësjiellësit dhe kanalizimit (53%) dhe në veçanti shërbimet e furnizimit me energji elektrike (mbi 92%) tarifat janë 'shumë të larta' ose 'të larta'. Në anën tjetër si shërbime që në masë të madhe konsiderohen të kenë tarifa 'të përballueshme' apo 'të ulëta' janë shërbimet e grumbullimit të mbeturinave (afër 69%) dhe shërbimet e telefonisë (rreth 62%).

5.4. Në ç`masë i paguajnë konsumatorët faturat për shërbimet publike?

Prurjet e këtij hulumtimi japin një pasqyrë që në masë të madhe reflekton situatën sociale të popullatës së Kosovës, dhe në masë më të vogël pasqyrojnë nivelin e kënaqshmërisë me cilësinë e shërbimeve (edhe pse në formë të përgjithshme niveli i kënaqshmërisë korrespondon me shkallën e deklaruar të pagesës së faturave për shërbimet përkatëse publike).

Nga analizimi i përgjigjeve të respondentëve për të gjitha shërbimet publike që kanë qenë pjesë e këtij hulumtimi, del se mbi 50% të tyre i paguajnë faturat rregullisht.

Tabela 5: Pagesa e shërbimeve publike

	Ujësjetillësi e Kanalizimi	Grumbullimi i Mbeturinave	Energjia Elektrike	Telefonia	Ngrohja Qendrore
Rregullisht	62.8 %	64.6 %	50.9%	93.8 %	47.2 %
Kohëpaskohe	29.8%	25.0 %	39.1 %	5.3 %	23.5%
Asnjëherë	7.4 %	10.4 %	10.0 %	0.9 %	29.4 %
Numri i respondentëve që u ofrohet shërbimi	1196	948	1200	437	34

Prurjet e hulumtimit rezultojnë se pagesa e rregullt e faturave për shërbimet e marra në masë të madhe reflekton kënaqshmërinë e konsumatorëve me nivelin e shërbimeve të ofruara dhe në masë më të vogël lartësinë ose përbalueshmërinë e tarifave për shërbimet respektive. Kështu numri më i madh i respondentëve që janë përgjigjur se paguajnë faturat ‘rregullisht’ është në rastin e shërbimeve të telefonisë (93.8%), ndërkaq numri më i vogël i respondentëve që paguajnë ‘rregullisht’ është për shërbimet e ngrohjes qendrore (47.2 %) dhe shërbimet e energjisë elektrike (50.9 %). Sa i përket shërbimeve që i rregullon ZRRUM, shërbimet e grumbullimit të mbeturinave rezultojnë se paguhen ‘rregullisht’ nga 64.6 të konsumatorëve, ndërkaq shërbimet e ujësjetillësit dhe kanalizimit nga 62.8 % e konsumatorëve.

Rezultatet e hulumtimit duhet të vështrohen edhe nga këndvështrimi i mostrës reprezentative (që është më e plotë për shërbimet e energjisë elektrike dhe ato të ujësjetillësit dhe më pak reprezentative të shërbimeve tjera), pastaj nga sinqeriteti i përgjigjeve (të dhënat për shkallën e arkëtimit të faturave për shërbimet e ujësjetillësit dhe mbeturinave nuk korrespondojnë plotësisht me rezultatet e hulumtimit), si dhe nga këndvështrimi i mekanizmave zbatues që kanë kompanitë përkatëse për realizimin e pagesës (PTK është në pozitën më të favorshme në këtë plan, ndërkaq kompanitë që ofrojnë shërbimet e grumbullimit të mbeturinave në pozitën më të disfavourshme).

Sa i përket arësive për mospagesë të shërbimeve të ujësjetillësit dhe mbeturinave, pjesa më e madhe e respondentëve (61.3%) kanë deklaruar se arsye për mospagesë është mungesa e mjeteve financiare. Pakënaqësia me shërbimet e ofruara është deklaruar si arsye për mospagesë në 28.5% të rasteve, ndërkaq mos-dërgimi i rregullt të faturave është deklaruar si arsye për mospagesë në 5.2% të rasteve.

6. Njohuritë e konsumatorëve për ZRRUM dhe për KKK

6.1. Njohuritë e konsumatorëve për Zyrën Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina

Pyetja rreth njohurisë së qytetarëve për Zyrën Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM) nxjerr në pah një çështje tjetër me rëndësi për këtë rregullator dhe për rregullatorët tjerë që funksionojnë në Kosovë, e që është njohuria e paktë që kanë qytetarët për ekzistencën dhe funksionin e këtyre rregullatorëve.

Shumica e konsumatorëve nuk kanë njohuri për ekzistencën dhe në veçanti për rolin dhe funksionin e ZRRUM. Vetëm 19.8 % të konsumatorëve kanë njohuri se ekziston ZRRUM, ndërsaq për rolin dhe funksionin e ZRRUM vetëm 7.2% të respondentëve janë deklaruar se kanë njohuri të mira.

6.2. Njohuritë e konsumatorëve për Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve

Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve (KKK) janë trupa të themeluar nga ZRRUM në bazë të ligjit. Këto komisione janë themeluar në 7 regjionet e Kosovës ku i operojnë dhe i ofrojnë shërbimet e veta kompanitë regjionale të ujësjellësit dhe ato të mbeturinave. Në përbërje të KKK-ve marrin pjesë nga 2 përfaqësues të komunave përkatëse që gravitojnë në regjionin respektiv. Funkzioni kryesor i KKK-ve është adresimi i problemeve të konsumatorëve lidhur me shërbimet e ujësjellësit dhe mbeturinave dhe zgjidhja e ankesave të cilat nuk janë zgjidhur në mënyrë të duhur dhe të kënaqshme nga ana e kompanive regjionale të ujësjellësit dhe mbeturinave.

Sipas hulumtimit, numri i konsumatorëve që kanë njohuri për ekzistencën e KKK-ve është edhe më i vogël se sa për ZRRUM. Kështu, përqindja e atyre që kanë dëgjuar për KKK-të është 7.5%, përkatësisht **vetëm 6.9% prej konsumatorëve të intervistuar kanë njohuri të mira për rolin dhe funksionin e KKK-ve.**

Një çështje tjetër që lidhet me KKK-të dhe që është trajtuar me këtë hulumtim është adresimi i ankesave nga konsumatorët tek KKK-të. Rezultatet e hulumtimit tregojnë se **vetëm 4.9% të konsumatorëve kanë adresuar së paku 1 herë ankesë tek KKK.** Arësyet për një numër kaq të vogël të konsumatorëve të cilët kanë adresuar ankesa tek KKK-të mund të jenë: (i) shkalla e ulët e njohurisë për ekzistencën dhe rolin e KKK-ve, dhe (ii) ndoshta mosbesimi në se ankesat e tyre do të adresohen dhe zgjidhen drejtë nga KKK.

Sa i përket përvojave konkrete të konsumatorëve lidhur me trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave të tyre nga KKK-të, 50% të respondentëve kanë deklaruar se mendojnë që akesa e tyre nuk është zgjidhur në mënyrë të drejtë nga KKK-të.

Në përgjithësi, rezultatet e hulumtimit tregojnë për një shkallë shumë të ulët të njohurive të konsumatorëve me ekzistencën si dhe për rolin dhe funksionin e KKK-ve. Poashtu, hulumtimi ka vënë në pah se përqindja e konsumatorëve që kanë shfrytëzuar mundësinë për tu ankuar tek KKK-të është shumë e vogël (4.9%).

Rezultatet e hulumtimit kanë konfirmuar perceptimet e ZRRUM se shkalla e njohurisë së konsumatorëve për ekzistencën dhe rolin e KKK-ve është shumë e ulët. Kjo imponon nevojën për zbatimin konsekuent nga ana e ZRRUM të një fushate të strukturuar të informimit të publikut për ekzistencën, rolin dhe funksionin e KKK-ve. Kjo do të kontribuonte në ngritjen e profilit të KKK-ve si dhe në ofrimin e mundësive shtesë për konsumatorët që ti adresojnë shqetësimet e tyre lidhur me shërbimet e ujësjellësit dhe mbeturinave.

7. Konkluzione dhe Rekomandime

Prurjet e këtij hulumtimi mund të jenë një udhërrëfyes i mirë për ndërmarrjen e veprimeve specifike dhe të koordinuara me qëllim të adresimit të pakënaqësive të konsumatorëve për shërbimet e ujësjellësit, kanalizimit dhe grumbullimit të mbeturinave. Poashtu rezultatet e hulumtimit kanë demonstruar se si qëndrojnë shërbimet e ujësjellësit dhe mbeturinave në raport me shërbimet tjera publike në opinionin e konsumatorëve.

Disa prej konkluzioneve që mund të nxirren nga ky hulumtim janë;

- **Përfshirja me shërbime:** Furnizimi me energji (me 100% shtrirje) dhe furnizimi me ujë (97.6%) janë shërbimet me të cilat janë të përfshirë më së shumti popullata. Ndërkaq ngrohja qendrore (me vetëm 2.4%) dhe telefonia fikse (me 36.8%) janë shërbimet me përfshirje më të ulët të popullatës. Shërbimet e mbeturinave (me 77.7%) dhe shërbimet e kanalizimit (me 86.6%) janë shërbime me përfshirje mjaft të lartë të popullatës.
- **Kënaqshmëria me shërbime:** Prej shërbimeve publike të trajtuara me këtë hulumtim, konsumatorët janë ***më së shumti të kënaqur*** me shërbimet e ***telefonisë fikse (mbi 90%)***, ndërkaq janë ***më së paku të kënaqur me shërbimet e furnizimit me energji elektrike (nën 14%)***. Sa i takon shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit si dhe shërbimeve të mbeturinave, shërbime këto që i rregullon ZRRUM, mbi 50% të konsumatorëve janë deklaruar se janë të kënaqur me këto shërbime (mbeturinat mbi 61% dhe ujësjellësi 52%).
- **Lartësia e tarifave:** Perceptimi i konsumatorëve lidhur me lartësinë e tarifave për shërbimet publike demonstroi se mbi ***92%*** e tyre i konsiderojnë tarifat e furnizimit me energji elektrike si ***të larta*** ose ***shumë të larta***. Në anën tjetër,

shërbimet e grumbullimit të mbeturinave konsiderohen si shërbime që kanë tarifatat më të përballueshme, respektivisht, vetëm 30% të konsumatorëve të intervistuar i konsiderojnë tarifatat për këtë shërbim si *të larta* ose *shumë të larta*. Sa i përket shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit më shumë se gjysma e konsumatorëve të intervistuar (mbi 52%) i konsiderojnë tarifatat për këto shërbime si *të larta* ose *shumë të larta*.

- **Pagesa e shërbimeve publike:** Përgjigjet e konsumatorëve lidhur me pagesën e shërbimeve publike në masë të madhe reflektojnë kënaqshmërinë e tyre me nivelin e shërbimeve si dhe përballueshmërinë e deklaruar të tarifave të shërbimit. Kështu, numri më i madh i respondentëve është deklaruar se i paguan rregullisht shërbimet e telefonisë fikse (rreth 94%). Në ekstremin tjetër janë shërbimet e furnizimit me energji elektrike; rreth 51% të konsumatorëve kanë deklaruar se i paguan rregullisht faturat e KEK-ut. Shërbimet e ujësjellësit (me 62.8%) dhe shërbimet e mbeturinave (me 64.6%) qëndrojnë mjaft afër në deklaratimet e qytetarëve lidhur me rregullshmërinë e pagesës së tyre.
- **Njohuritë e konsumatorëve për ZRRUM:** nga hulumtimi rezulton se një numër shumë i vogël i konsumatorëve (rreth 20%) ka njohuri për ekzistencën e ZRRUM. Ndërkaq numri i atyre që kanë njohuri të qarta për rolin dhe funksionin e ZRRUM është edhe më i vogël (rreth 7%).
- **Njohuritë e konsumatorëve për Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve:** Ashtu siq edhe ka supozuar ZRRUM, njohuritë e konsumatorëve për ekzistencën e KKK-ve janë shumë të vogla – vetëm 7.0% të konsumatorëve kanë deklaruar se kanë njohuri për rolin dhe funksionin e KKK-ve.

Konsumatorët përmes participimit në këtë hulumtim kanë treguar gatishmërinë e tyre që në një mënyrë të kontribuojnë që kjo gjendje të ndërrohet në aspekt pozitiv. Mbetet shqetësues fakti se ekziston një shkallë e lartë e pakënaqësisë së konsumatorëve për nivelin e shërbimeve publike që kanë qenë objekt i trajtimit me këtë hulumtim. Poashtu një pjesë e konsiderueshme e qytetarëve nuk kanë qasje në shërbimet e caktuara publike, veçanti në shërbimet e mbeturinave dhe kanalizimit (hiq shërbimet e telefonisë dhe të ngrohjes qendrore që nuk janë në mandatin e ZRRUM). Prandaj, imponohet nevoja e zgjerimit të këtyre shërbimeve për të gjithë qytetarët e Kosovës, duke pasur parasysh rëndësinë e tyre për shëndetin publik dhe mirëqenien e popullatës. Natyrisht, zgjerimi i këtyre shërbimeve duhet të përcillet me ngritjen e cilësisë së shërbimeve, respektivisht arritjen dhe mbajtjen e standardeve të kërkuara të shërbimit.

Disa prej rekomandimeve specifike nga ky hulumtim që kërkojnë vëmendje të duhur dhe adresim adekuat, mund të përmblihen në sa vijon:

- Sensibilizimi i opinionit për ekzistimin e ZRRUM dhe Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve (KKK). Sigurisht që aktivitetet në formë të fushatave për ngritjen e vetdijes së konsumatorëve për ZRRUM, KKK, si dhe të drejtat dhe obligimet e konsumatorëve në raport me shërbimet e ujësjellësit dhe mbeturinave janë të domosdoshme.

- Është e nevojshme që të ngritet niveli i mbikqyrjes së kompanive publike të ujësjellësit dhe mbeturinave në lidhje me cilësinë e shërbimeve ndaj konsumatorëve për tu siguruar se ato ofrojnë standard të mirë të shërbimit në pajtim me obligimet e tyre ligjore të përcatuara me kornizën rregullatore. Kjo për faktin se në shumë raste, konsumatorët kanë deklaruar se vonesa e dërgimit të faturave, apo figurimi i borxhit paraprak në faturë, ndikon negativisht në përmbushjen e obligimeve të qytetarëve ndaj kompanive përkatëse.
- Duhet që të krijohen politika dhe strategji për zgjerimin e shtrirjes së këtyre shërbimeve në të gjithë vendbanimet. Kjo veçanërisht vlen për shërbimin e kanalizimit dhe atë të grumbullimit të mbeturinave. Një hap i tillë përpos ngritjes së kualitetit të jetesës dhe ruajtjes së shëndetit publik do të kishte rëndësi fundamentale edhe në ruajtjen e mjedisit.

***Shtojca 1:
Të Dhënat Statistikore të Hulumtimit***

Gjinia

		Frekuenca	Përqindja	Përqindja valide	Përqindja kumulative
Valid	Mashkull	722	60.2	60.2	60.2
	Femër	478	39.8	39.8	100.0
	Total	1200	100.0	100.0	

Mosha

		Frekuenca	Përqindja	Përqindja valide	Përqindja kumulative
Valid		2	.2	.2	.2
	18	4	.3	.3	.5
	19	15	1.3	1.3	1.8
	20	23	1.9	1.9	3.7
	21	8	.7	.7	4.3
	22	21	1.8	1.8	6.1
	23	11	.9	.9	7.0
	24	20	1.7	1.7	8.7
	25	14	1.2	1.2	9.8
	26	13	1.1	1.1	10.9
	27	18	1.5	1.5	12.4
	28	33	2.8	2.8	15.2
	29	22	1.8	1.8	17.0
	30	32	2.7	2.7	19.7
	31	21	1.8	1.8	21.4
	32	36	3.0	3.0	24.4
	33	26	2.2	2.2	26.6
	34	23	1.9	1.9	28.5
	35	27	2.3	2.3	30.8
	36	29	2.4	2.4	33.2
	37	32	2.7	2.7	35.8
	38	24	2.0	2.0	37.8
	39	24	2.0	2.0	39.8
	40	52	4.3	4.3	44.2
	41	29	2.4	2.4	46.6
	42	32	2.7	2.7	49.3
	43	32	2.7	2.7	51.9
	44	23	1.9	1.9	53.8
	45	37	3.1	3.1	56.9
	46	23	1.9	1.9	58.8
	47	26	2.2	2.2	61.0
	48	19	1.6	1.6	62.6
	49	15	1.3	1.3	63.8
	50	39	3.3	3.3	67.1
	51	23	1.9	1.9	69.0

52	27	2.3	2.3	71.3
53	27	2.3	2.3	73.5
54	18	1.5	1.5	75.0
55	18	1.5	1.5	76.5
56	21	1.8	1.8	78.3
57	17	1.4	1.4	79.7
58	18	1.5	1.5	81.2
59	15	1.3	1.3	82.4
60	26	2.2	2.2	84.6
61	11	.9	.9	85.5
62	13	1.1	1.1	86.6
63	22	1.8	1.8	88.4
64	10	.8	.8	89.3
65	24	2.0	2.0	91.3
66	7	.6	.6	91.8
67	8	.7	.7	92.5
68	7	.6	.6	93.1
69	11	.9	.9	94.0
70	14	1.2	1.2	95.2
71	4	.3	.3	95.5
72	14	1.2	1.2	96.7
73	10	.8	.8	97.5
74	4	.3	.3	97.8
75	11	.9	.9	98.8
76	2	.2	.2	98.9
77	1	.1	.1	99.0
78	5	.4	.4	99.4
79	2	.2	.2	99.6
80	2	.2	.2	99.8
81	1	.1	.1	99.8
82	1	.1	.1	99.9
84	1	.1	.1	100.0
Total	1200	100.0	100.0	

Tipi i vendbanimit

		Frekuenca	Përqindja	Përqindja valide	Përqindja kumulative
Valid	Fshat	398	33.2	33.2	33.2
	Qytezë	78	6.5	6.5	39.7
	Qytet	724	60.3	60.3	100.0
	Total	1200	100.0	100.0	

Shkalla e arsimimit

		Frekuenca	Përqindja	Përqindja valide	Përqindja kumulative
Valid	Pa shkollë	40	3.3	3.3	3.3
	Shkollë tetëvjeçare të papërfunduar	106	8.8	8.8	12.2
	Shkollë tetëvjeçare të përfunduar	292	24.3	24.4	36.5
	Shkollë e mesme	513	42.8	42.8	79.3
	Shkollë e lartë ose fakulteti i papërfunduar	136	11.3	11.3	90.7
	Fakultet	103	8.6	8.6	99.2
	Master/Doktor shkence/Specialist	9	.8	.8	100.0
	Total	1199	99.9	100.0	
Missing	System	1	.1		
